



Bordi

VENDIM

Nr. 17 Datë 16.02.2016

PËR

LICENSIMIN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET, “CEREMI” DHE “DRAGOBIA” ME FUQI TOTALE TE INSTALUAR 21900 KW

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; nenit 13 dhe 14 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2016, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k për licensim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” “c”) është plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për Hec (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k, ne aktivitetin e prodhimit te energjisë elektrike nga Hec-et ‘Ceremi’ me fuqi 8600 KW dhe “Dragobia” me fuqi të instaluar 13300 KW, (me fuqi totale te instaluar 21900 KW) për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve te ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.